

Miratoi:

Kryetari

Z. ARTUR BUSHI



REPUBLIKA E SHQIPERISE


BASHKIA KRUJE

OBJEKTI: "REHABILITIMI DHE PASTRIMI I PERROIT TE KRESHNICES,
ZALL - FUSHE KRUJE"

RAPORT TEKNIK

PERGATITI:


"ENGINEERING CONSULTING GROUP" SHPK



TIRANE 2024

ENGINEERING CONSULTING GROUP

HEAD OFFICE - TIRANE; [Mob:+355 69 40 98 814](tel:+355694098814) NIPT: M 01308013 C
Str. "Arkitekt Kasemi", Building No.22, "Brryli", Tiranë; e-mail: ecgroup20@gmail.com



Permbajtja

1.	TE PERGJITHSHME	3
1.1	Pershkrimi i zones se projektit	3
1.2	Klima.....	4
1.3	Diellezimi:.....	6
1.4	Era:	7
1.5	Ekonomia	7
2.	QELLIMI I PROJEKTIT.....	7
2.1	Vendndodhja e objektit	7
2.2	Objektivat.....	8
3.	ZGJIDHJA TEKNIKE.....	9
3.1	Realizimi i punimeve	9
3.2	Mjetet per realizimin e punimeve.....	10

ENGINEERING CONSULTING GROUP

HEAD OFFICE - TIRANE; [Mob:+355 69 40 98 814](tel:+355694098814) NIPT: M 01308013 C
 Str. "Arkitekt Kasemi", Building No.22, "Brryli", Tiranë; e-mail: ecgroup20@gmail.com

1. TE PERGJITHSHME

1.1 Pershkrimi i zones se projektit

Fushe-Kruja eshte nje qytet ne Shqiperi me rreth 27000 banore, afer qytetit te lashte te Krujes.


Gjeografikisht Fushe kruja, Shtrihet 10 km ne Perendim te qytetit te Krujes, dhe njekohesisht te vargmaleve Kruje-Dajt. Eshte 15 m mbi nivelin e detit.

Pozicioni i saj gjeografik eshte i rendesishem pasi sherben si nyje lidhese te Veriut dhe Lindjes se Shqiperise me Tiranen dhe Durresin. Pershkohet nga rruga Shkoder-Fushe-Kruje-Tirane dhe te gjithe rrugeve te tjera qe lidhen me rrugen ne Milot, Eshte rruga Burrel-Qaf-Shtame-Kruje-Fushe-Kruje-Vore-Durres. Pershkohet nga Hekurudha Zalle-Budull, dhe ne periferi te saj nga hekurudha Vore-Budull-Shkoder.



Figura 1: Harta e Qarkut Durrës

Fusha eshte shume pjellore, sidomos per drithera dhe zarzavate dhe Kodrat perreth ne lindje Zalle. Kullas, Zeze qe vecanarisht jane te mira si njesi bujqesore per mbjelljen e pemeve e kryesisht te rrushit.



Ajo ka nje siperfaqe afersisht 100 km katrore me fshatra ne fushe qe kane zene siperfaqe te shumte per truall duke cenuar token bujqsores.

Pershkohet permes nga lumi i Zezes qe kalon nga fshati Zeze dhe ka marr te njehtin emer dhe buron nga fshatrat e pas Krujes dhe kalon ne shkallen e Krujes. Shteron ne vere dhe eshte bere i padobishem per vaditje si pasoje e ndotjes.

Ne perendim Fushe Kruja pershkohet nga lumi i Gjoles dhe ky shume i ndotur.

Ne jug pershkohet nga lumi i Terkuzes, qe kalon ne Tapize Qereke Rinas dhe derdhet ne lumin e Tiranes.

Ne veri pershkohet nga perroi i Bardharit qe buron nga Fushe-Madhja ne anen Jugore te Krujes kalon ne Halil dhe bashkohet me lumin Zeze. Ky perrua eshte shume i rrembyeshem dhe ne vere shteron.

E gjithë zona eshte toke e zeze dhe e rende, aty ka disa rezurvuare artificiale si ai i Bacungut, Tapizes, me rrjet vaditje e kullimi te pa mirembajtur prej shume vitesh.

1.2 Klima

Ne nenzonen mesdhetare jugore ndryshimi ditor i temperatures shkon nga nje minimum rreth agimit, ne nje maksimum nga 1 deri 3 ore mbasi dielli ka arritur ne zenith, mbas te ciles ka nje renie te vazhdueshme gjate nates deri ne agim.

Temperatura mesatare ditore eshte mesatarja e temperatures maksimale dhe minimale dhe normalisht eshte brenda kufirit te mesatares te vertete qe regjistrohet ne menyre te vazhdueshme.

ENGINEERING CONSULTING GROUP


HEAD OFFICE - TIRANE; [Mob:+355 69 40 98 814](tel:+355694098814) NIPT: M 01308013 C
Str. "Arkitekt Kasemi", Building No.22, "Brryli", Tiranë; e-mail: ecgroup20@gmail.com

Fushë-Kruja climate table


Annual climate table of maximum and minimum daily temperatures (°C) and precipitation (mm).

Climate table • Fushë-Kruja (Albania)												
	Jan	Feb	mar	apr	May	June	July	Aug	Sep	Oct	Nov	dec
MAX	12°	14°	16°	20°	24°	28°	30°	30°	26°	22°	17°	13°
MINUTES	1°	2°	4°	8°	13°	17°	19°	19°	16°	11°	6°	3°
PRECIPIT...	139	121	119	103	80	58	37	46	87	123	170	151
	Jan	Feb	mar	apr	May	June	July	Aug	Sep	Oct	Nov	dec

Fushë-Kruja temperatures throughout the year



Fushë-Kruja precipitation throughout the year




Average annual precipitation is about **1,234 mm** .

Kjo zone karakterizohet nga diferenca te medha intesitetesh, reshjesh.

Gjate kohes se kryerjes se punimeve, subjekti zbatues duhet te kete parasysh sinkronizimin e punimeve me ndryshimet klimaterike, me qellim moskrijimin e problemeve me pasoje permbytjen si rezultat i moslargimit te dherave nga shtrati i lumit.

1.3 Diellzimi:

Nje nga elementet baze qe karakterizon klimen e nje zone eshte regjimi i diellzimit qe shprehet nepermjet numrit te diteve te kthjellta dhe atyre te vraneta. Per zonen ne studim, numri i diteve te kthjellta luhetet nga 6-7 dite ne muajt e dimrit dhe 16-19 dite ne muajt e veres. Per ditet e vraneta situata paraqitet ne kahe te kundert dhe konkretisht mesatarisht gjate vitit vrojtohen rreth 1-2 dite te vraneta ne kohen e veres dhe 10-12 dite te tilla ne kohen e dimrit. Nje parameter tjeter qe karakterizon rregjimin e diellzimit eshte rrezatimi i pergjithshem diellor qe shpreh energjine diellore e shprehur ne kalori per njesi te siperfaqes kal/cm². Per hapesiren Tirane Durres ky lloj parametri matet vetem ne vendmatjen e Tiranes dhe ne baze te te dhenave rezulton se vlerat mujore te rrezatimit te pergjithshem luhaten nga



135.6kal/cm² ne muajin dhjetor deri 570 kal/cm² ne muajin korrik. Keto shifra tregojne nje potencial te konsiderueshem energjie diellore ne zonen ne studim, gje qe presupozon kushte shume te favor shme per zhvillimin ekonomik te kesaj zone.

1.4 Era:

Era fryn, përgjithësisht nga dy drejtime, gjatë periudhës së ftohtë mbizotëron juglindja pa përjashtuar veriun. Në periudhën e ngrohtë të vitit kudo mbizotëron veriperëndimi. Sipas vërtetimeve që janë bërë në vendin tonë shpejtësitë konsiderohen mesatare në këtë zonë kodrinoro - fushore.

1.5 Ekonomia

Fushe-Kruja renditet ne qendrat me nje zhvillim te mire ekonomik, tregtare te vendit. Jo vetem qyteti i Fushe-Krujes, por i gjithe rrethi ne teresi ka luajtur historikisht nje rol shume te rendesishem ne zhvillimin ekonomik te krejt vendit.

Ne kete zone jane te mundshme per t'u zhvilluar te gjitha aktivitetet ekonomike. Megjithate midis tyre vlen te veçohen sektore te tille si industria e cimentos, e mobilerise, ekonomia bujqesore.

2. QELLIMI I PROJEKTIT

2.1 Vendndodhja e objektit

Kjo zonë përfshihet në pjesen qendrore të vendit tonë. Relievi është fushoro - kodrinor. Vendndodhja e objektit eshte prane fshatit Zall, Kruje.

ENGINEERING CONSULTING GROUP

HEAD OFFICE - TIRANE; [Mob:+355 69 40 98 814](tel:+355694098814) NIPT: M 01308013 C
Str. "Arkitekt Kasemi", Building No.22, "Brryli", Tiranë; e-mail: ecgroup20@gmail.com





Figura 2: Ortofoto e zones se marre ne studim

2.2 Objektivat

Nepermjet projektit "Rehabilitimi dhe pastrimi i Perroit te Kreshnices, Zall - Fushe Kruje", synohet:

- Te behet sistemimi i shtratit te perroit te Kreshnices ne zonen Zall – Fushe Kruje dhe pastrimi i kanalit anes rruges
- Te behet pastrimi i zones nga materialet e nxjerra nga germimet.



3. ZGJIDHJA TEKNIKE

3.1 Realizimi i punimeve

Per realizimin e punimeve te rehabilitimit te perroit, do te kryhen punime germimi me ekskavator me goma, i cili do te largoje materialet aluviale te sjella nga vershimi i perroit, mbetjet urbane te hedhura ne perrua, si dhe do te unifikoje siperfaqen e seksionit hidraulik.

Ne te njejten kohe me germimet do te behet rrafshimi i skarpatave te perroit, qellimi i rrafshimit te skarpatave eshte moslejimi i shkeputjeve lokale te materialeve.

Rrafshimi do te kryhet me kujdes pasi efektet e agjenteve atmosferik, vershimit te perroit, gravitacionale, etj., mund te shkaktojne shkeputje pjesore te materialit, duke sjelle shtimin e erozionit, ndryshimin e seksionit hidraulik te perroit, dhe ndryshimin e regjimit te rrjedhes.

Punimet e germimit dhe rrafshimit do te behen sipas seksionit tip te paraqitur ne vizatime.

Materialet e nxjerra nga germimet dhe sistemimet do te transportohen me kamiona me kapacitet (10 - 15) m³, per rreth 10 km larg nga vendi i punimeve. nuk lejohet ne menyre kategorike qe materialet e nxjerra te shkarkohen ne berrmat e perroit.

Ne rastet kur eshte e nevojshme, keto materiale mund te riperdoren per qellime te caktuara rrafshimi ose mbushje, por vetem pasi jane miratuar nga inxhinieri zbatues, mbikqyresi dhe/ose laborator i akredituar i testimit te materialeve te ndertimit.

Pjerresia e skarpatave jepet ne vizatime, por mund te ndryshoje, ne varesi te terrenit, kur e gjykon inxhinieri zbatues dhe mbikqyresi se eshte e domosdoshme.

Te mbahet parasysh se punimet zhvillohen ne nje zone ku prane perroit ka prona private, te zhvillohen takime me autoritet lokale si dhe banoret e zones, per rendesine e kryerjes me perpikmeri te punimeve.

ENGINEERING CONSULTING GROUP

HEAD OFFICE - TIRANE; [Mob:+355 69 40 98 814](tel:+355694098814) NIPT: M 01308013 C
Str. "Arkitekt Kasemi", Building No.22, "Brryli", Tiranë; e-mail: ecgroup20@gmail.com





Figura 3 – seksioni terthor tip i prites (para dhe pas nderhyrjes)

3.2 Mjetet per realizimin e punimeve

Kontraktuesi do te siguroje automjete per perdorim nga inxhinieret dhe stafi. Ai do te perfshije per te gjitha detyrimet dhe shtesat per tarifat e regjistrimit, fitimin, amortizimin, interesin, demshperblimin dhe sigurimin. Automjetet duhet te jene te siguruara ne menyre gjithepershiresore per te mbuluar cdo shofer.

Mjetet e meposhtme duhet te sigurohen per realizimin e punimeve:

- Lloji i automjetit “Tip A”: Automjete (4+1) qe do te perdoren nga inxhinieret gjate zbatimit te punimeve, zakonisht me karroceri
- Automjeti “Tip B”: automjete per transportin e punetoreve (per rastet kur jane alrg zones ku kryhen punimet)



- Mjet “Tip C”: Ekskavator me goma me krahun deri ne 8 meter
- Mjet “Tip D”: Kamion (10-15) m³

Te gjitha automjetet duhet te pajisen me nje sistem radio-komunikimi, dhe me sistem ngrohje-ftohje.

Te gjitha automjetet do te jene ne dispozicion te stafit perpara nisjes se punimeve. Kontraktuesi do te beje rregullime te tjera dhe do te mbuloje kostot, per transportin alternativ.

Automjetet do te mbeten pergjegjesi e Kontraktuesit gjate gjithe Kontrates.

Kontraktuesi do te siguroje mirembajtje te rregullt per mjetet ne perputhje me rekomandimet e prodhuesit te automjetit. Ai do te rregulloje defektet, furnizimet me karburant, lubrifikuesit dhe materialet e tjera te konsumit.

Kontraktuesi do te jete pergjegjes per zevendesimin qofte te perkohshem apo te perhershem, te çdo mjeti i cili del jashte sherbimit.

Kontraktuesi do te siguroje nje numer shoferesh per perdorimin ekskluziv te mjeteve te stafit dhe te inxhinierëve. Ai do te mbuloje te gjitha tarifat dhe shpenzimet per te siguruar secilin shofer per nje program pune tete (8) ore / dite, pese (5) dite / jave.

ENGINEERING CONSULTING GROUP

HEAD OFFICE - TIRANE; [Mob:+355 69 40 98 814](tel:+355694098814) NIPT: M 01308013 C
Str. "Arkitekt Kasemi", Building No.22, "Brryli", Tiranë; e-mail: ecgroup20@gmail.com